



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 223

Tiranë – E hënë, 28 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

| | Faqe |
|---|--|
| Dekret i Presidentit nr. 9360, datë 14.12.2015 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 14599 |
| Dekret i Presidentit nr. 9361, datë 14.12.2015 | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 14599 |
| Dekret i Presidentit nr. 9362, datë 16.12.2015 | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 14599 |
| Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 645, datë 14.12.2015 | Për rregullat dhe procedurat për marrjen e informacionit dhe verifikimin e të dhënave e të deklarimeve nga vendi i origjinës për azilkërkuesin dhe refugjatën..... 14600 |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 73, datë 14.12.2015 | Me objekt shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-3127, datë 4.6.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... 14601 |
| Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 971, datë 17.12.2015 | Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Kristian Demokrate të Shqipërisë në qarkun Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 14608 |
| Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 60, datë 14.12.2015 | Për shqyrtimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 15.7.2015, “Për disa shtesa në vendimin nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar”..... 14610 |
| Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 61, datë 14.12.2015 | Për përcaktimin e normës së interesit për kthimin e ndihmës shtetërore për vitet 2010-2015..... 14615 |

| | | |
|--|--|-------|
| Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 62, datë 14.12.2015 | Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit”.... | 14616 |
| | Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Andre Prifti..... | 14618 |
| | Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ismet Kacabumi..... | 14618 |
| | Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Maksim Likaj..... | 14618 |

**DEKRET**

Nr. 9360, datë 14.12.2015

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Mehmet Akif Halil Demircan
2. Mustafa Orhan Ihsan Aral
3. Athanasios Menelaos Pappas
4. Fjolla Ahmet Ademi (Arifi)
5. Hana Pjetër Spaçi
6. Rajshri Bakulbhai Rathod
7. Denis Kapllan Zhara
8. Lulzim Idriz Hasani
9. Teuta Isuf Hasani (Alili)
10. Nue Nik Kalaj
11. Osman Nuh Elkaya
12. Fedaije Pajazit Osmani (Hajrizi)
13. Pashk Prek Lekaj
14. Ceyhun Ali Riza Kocaoğlu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 9361, datë 14.12.2015

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Gjorgjije Bogiq Vuçiq (Jugu)
2. Zdravko Gjorgjije Vuçiq (Jugu)
3. Denis Gjorgjije Vuçiq (Jugu)
4. Vido Jako Zlatičanin (Tatiçaj)
5. Snežana (Snezhana) Vido Zlatičanin (Tatiçaj)
6. Lidia Llabut Kontiq (Dritarja)
7. Anna Paola Kolë Pjetri
8. Odeta Avdi Staben (Ismalaj)
9. Realda Roland Osmani
10. Kreshnik Haqif Sulaj
11. Velko Gligo Brajoviq (Ferezaj)
12. Florika Fani Brajoviq (Gremi)
13. Voltida Velko Brajoviq (Ferezaj)
14. Endri Velko Brajoviq (Ferezaj)
15. Andi Zenun Begzati
16. Bledi Gole Vasha
17. Mikel Bledi Vasha
18. Altea Bledi Vasha
19. Lindita Maksim Memaj
20. Gentiana Leonard Kristo
21. Vjollca Qerim Abdurahmani (Metaj)
22. Klodian Fatmir Shehu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 9362, datë 16.12.2015

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Anjeza Suat Bichlmeier (Valishti)
2. Elvana Bahri Kodraj (Topalli)
3. Elena Arben Kodraj
4. Ambra Arben Kodraj
5. Elira Shpend Bajrami
6. Blerim Bashkim Halili
7. Aurora Bilbil Luzi (Bregu)
8. Enedio Helidon Dita
9. Eriona Fatos Jaho
10. Alma Kastriot Imperioso (Sherifaj)
11. Dajana Agron Xhemalaj
12. Adelina Hamdi Sylshabanaj (Cara)
13. Nadire Hamit Myderizi
14. Enkelejda Liri Aoshi (Koçi)
15. Erlinda Kastriot Sheme
16. Elsa Mark Ndoj
17. Aylin Taner Zherdi
18. Leyla Taner Zherdi
19. Valbona Kadri Halilaj (Toska)
20. Lubin Risto Belkovi
21. Fiona Lubin Belkovi
22. Kristian Lubin Belkovi
23. Ledina Enver Belkovi (Muzhaqi)
24. Migena Simion Vaso

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

UDHËZIM

Nr. 645, datë 14.12.2015

**PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT
PËR MARRJEN E INFORMACIONIT
DHE VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE E
TË DEKLARIMEVE NGA VENDI I
ORIGINËS PËR AZILKËRKUESIN DHE
REFUGJATIN**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 121 dhe 124, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të

Republikës së Shqipërisë”, të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Drejtuesi i autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, cakton një specialist të këtij autoriteti, për verifikimin e të dhënave që mbledhen gjatë aplikimit dhe intervistimit për azil, në institucionet shtetërore, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, në lidhje me gjendjen e përgjithshme që mbizotëron në vendet e origjinës së azilkërkuesit dhe refugjatit dhe kur është e nevojshme, në vendet përmes të cilave ata kanë qenë transit.

2. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, mund të kërkojë informacion pranë Drejtorisë për Bashkëpunimin dhe Koordinimin Ndërkombëtar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, me qëllim verifikimin e deklarimeve të azilkërkuesit dhe të refugjatit. Drejtoria për Bashkëpunimin dhe Koordinimin Ndërkombëtar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit pas verifikimit të informacionit, ia paraqet atë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, brenda 5 ditëve pune për trajtimin e tij në dhënien e vendimeve sipas parashikimeve të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

3. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, mund të kërkojë informacion, pranë Drejtorisë së Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, brenda fushës së kompetencës së kësaj drejtorie, me qëllim verifikimin e deklarimeve të azilkërkuesit dhe refugjatit, për vendet përmes të cilave ata kanë qenë transit. Kjo drejtori, pas verifikimit të informacionit, ia paraqet atë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, brenda 5 ditëve pune, për trajtimin e tij në dhënien e vendimeve sipas parashikimeve të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

4. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, mund të kërkojë informacion pranë Shërbimit Informativ të Shtetit, me qëllim mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave dhe deklarimeve të azilkërkuesit dhe refugjatit. Shërbimit Informativ i Shtetit, pas verifikimit të informacionit, ia paraqet atë autoritetit përgjegjës



për azilin dhe refugjatët, brenda 5 ditëve pune për trajtimin e tij në dhënien e vendimeve sipas parashikimeve të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

5. Informacioni në përputhje me klasifikimin e tij, mund të kërkohet apo të jepet paraprakisht nëpërmjet postës elektronike zyrtare dhe më pas me shkresë zyrtare.

6. Informacioni i mbledhur administrohet në dosjen personale të azilkërkuesit dhe refugjatit.

7. Rregullat dhe procedura për marrjen e informacionit dhe verifikimin e të dhënave dhe të deklarimeve nga vendi i origjinës për azilkërkuesin dhe refugjatit, të parashikuara në këtë udhëzim, zbatohen për aq sa është e mundur edhe për personat që kanë përfutur statusin e mbrojtjes plotësuese dhe ata në mbrojtje të përkohshme.

8. Urdhri i ministrit të Brendshëm nr. 752, datë 9.12.2009, “Për marrjen e informacionit dhe verifikimin e deklarimeve, nga vendi i origjinës së azilkërkuesit”, revokohet.

9. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

VENDIM
Nr. 73, datë 14.12.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | |
|-----------------|-----------|----------------------|
| Bashkim Dedja | kryetar i | Gjykatës Kushtetuese |
| Vladimir Kristo | anëtar i | “ “ |
| Vitore Tusha | anëtare e | “ “ |
| Fatmir Hoxha | anëtar i | “ “ |
| Gani Dizdari | anëtar i | “ “ |
| Besnik Imeraj | anëtar i | “ “ |
| Fatos Lulo | anëtar i | “ “ |
| Sokol Berberi | anëtar i | “ “ |

me sekretare Edmira Babaj, në datën 1.10.-2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 48 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Eurondërtim 2000” sh.p.k.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria “Albtransport” sh.a. (aeroporti “Nënë Tereza”)

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-3127, datë 4.6.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, shoqërisë “Eurondërtim 2000” sh.p.k., e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë “Albtransport” sh.a. (aeroporti “Nënë Tereza”), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja dhe subjekti i interesuar, shoqëria “Albtransport sh.a.” (sot aeroporti “Nënë Tereza”), kanë lidhur në datën 9.7.2002 një kontratë sipërmarrjeje për realizimin e punimeve të ndërtimit dhe rikonstruksionit të disa ambienteve aeroportuale të aeroportit “Nënë Tereza”. Referuar vendimeve gjyqësore kërkuases i është kërkuar në mënyrë verbale kryerja e punimeve shtesë në sipërfaqen prej 69.46 m². Për mospërbushje të detyrimeve kontraktore nga ana e subjektit të interesuar për këtë shtesë punimesh, kërkuasesja i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3301, datë 26.5.2005, ka vendosur, ndër të tjera, pranimin e padisë dhe detyrimet monetare përkatëse që subjekti i interesuar duhet t’i paguajë kërkuases për investimet e kryera, përdorimin e sendit dhe dëmin e shkaktuar.

3. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim subjekti i interesuar. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1167, datë 7.11.2006, ka vendosur



lënien në fuqi të vendimit nr. 3301, datë 26.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i investuar me rekurs nga subjekti i interesuar, me vendimin nr. 00-2009-1054, datë 6.10.2009, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1167, datë 7.11.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të moskryerjes së një hetimi të plotë e të gjithanshëm, dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

5. Pas rigjykimit Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 843, datë 6.5.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3301, datë 26.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Subjekti i interesuar ka ushtruar rekurs ndaj këtij vendimi dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-3127, datë 4.6.2014, ka vendosur prishjen e vendimeve nr. 3301, datë 26.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. 843, datë 6.5.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe rrëzimin e padisë.

II

7. **Kërkuesja**, shoqëria “Eurondërtim 2000” sh.p.k., i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në Gjykatën e Lartë. Më konkretisht, ajo ka parashtruar se është cenuar e drejta për t’u mbrojtur, barazia e armëve gjatë gjykimit dhe parimi i kontradiktorialitetit, pasi Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën e përfaqësimit me avokat. Sipas kërkueses, megjithëse ajo ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore për shkak të dorëheqjes nga përfaqësimi të avokates së saj një ditë para seancës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka vazhduar gjykimin në mungesë të saj. Kjo, sipas kërkueses, e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues.

8. **Subjekti i interesuar**, shoqëria “Albtransport” sh.a. (aeroporti “Nënë Tereza”), ka parashtruar se:

8.1 Kërkesa e paraqitur është e pambështetur në ligj dhe duhet të rrëzohet.

8.2 Kërkesa e dytë për shtyrjen e seancës në Gjykatën e Lartë në datën 4.6.2014 dukej jo si një shkak objektiv, por më tepër si një mjet për zvarritjen e procesit gjyqësor. Gjykata e Lartë e ka shtyrë njëherë seancën për shkak të mungesës

së avokates së kërkueses dhe me të drejtë herën e dytë, kur është kërkuar sërish shtyrje, ka vendosur për vazhdimin e gjykimit.

8.3 Gjykata e Lartë shqyrton dokumentet dhe faktet e paraqitura nga palët në mënyrë autonome dhe të pavarur nga përfundimet e palëve, çka nënkupton se mospjesëmarrja e avokatit të njëres palë në shqyrtimin e rekursit nuk cenon parimet e barazisë dhe të kontradiktoritetit në gjykim.

8.4 Kërkuesja nuk e ka ngritur në nivel kushtetues cenimin e parimit të paanshmërisë së gjykatës. Ajo nuk ka paraqitur argumente për të provuar se gjykata nuk ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme (testi objektiv) dhe se ka pasur interesa personale në çështjen në shqyrtim (testi subjektiv).

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A) Lidhur me legjitimitimin e kërkueses

9. Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e saj, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

10. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, vërehet se kërkuesja ka ngritur pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes. Gjykata në vijim ka marrë në shqyrtim këtë pretendim të kërkuesit në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B) Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë

11. Kërkuesja ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i ka mohuar të drejtën e përfaqësimit me avokat në shkelje të neneve 31/ç, 33 dhe 42 të Kushtetutës. Kërkuesja ka kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore të datës 4.6.2014 për shkak të paraqitjes së dorëheqjes në datën 3.6.2014 të avokates së zgjedhur prej saj, e cila ia ka komunikuar këtë dorëheqje edhe Gjykatës së Lartë. Për arsye të kohës së shkurtër



në dispozicion kërkuesja nuk ka mundur të gjejë avokat tjetër dhe ka kërkuar shtyrjen e seancës, kërkesë e cila nuk është pranuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, kërkuesja pretendon se është cenuar e drejta për t'u mbrojtur, barazia e armëve dhe parimi i kontradiktoritetit në gjykim.

12. Për sa i përket së drejtës së mbrojtjes, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj të konsolidua, ka theksuar se të drejtat e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt në kuptimin kushtetues. Gjykata e ka vlerësuar të drejtën e mbrojtjes si element thelbësor të një procesi të rregullt. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 6, datë 26.2.2013; nr. 37, datë 19.9.2011; nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit kërkon që secilës palë në gjykim t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta sipas kushteve, të cilat nuk e vendosin në disavantazh ndaj kundërshtarit. Secila palë duhet të ketë mundësi të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë në datën 20.5.2014 avokatja e kërkueses ka kërkuar shtyrjen e seancës, pasi nuk mund të paraqitej në Gjykatën e Lartë për arsye shëndetësore. Kjo

kërkesë e avokates, e paraqitur në seancë nga administratori i kërkueses Q.S., në cilësinë e përfaqësuesit të saj, është pranuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i cili e ka e shtyrë gjykimin në datën 4.6.2014. Në seancën pasardhëse të datës 4.6.2014, përfaqësuesi i kërkueses Q.S. ka bërë me dije Gjykatën e Lartë se është njoftuar për dorëheqjen e avokates një ditë më parë, ndaj në pamundësi për t'u përfaqësuar gjatë gjykimit me avokat ka kërkuar sërish shtyrjen e seancës. Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar këtë kërkesë dhe ka vazhduar gjykimin pa praninë e avokates së kërkueses.

16. Pjesëmarrja e avokatëve të palëve gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë parashikohet nga neni 483 i Kodit të Procedurës Civile (KPC). Sipas këtij neni, pas relatimit të çështjes nga relatori, avokatët e palëve paraqesin mbrojtjen e tyre dhe në të njëjtën seancë mund t'i paraqesin gjykatës mendimet e tyre, shkurtimisht, me shkrim. Ndryshe nga shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi, ku Kolegji i Gjykatës së Lartë vendos mbi pretendimet e paraqitura me shkrim të palëve, pa praninë e avokatëve, në rastet e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, prania e avokatëve merr rëndësi të veçantë për të paraqitur mbrojtjen e palës që përfaqësojnë, në respekt të parimeve të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Këto parime i imponojnë Gjykatës së Lartë detyrimin për marrjen e të gjitha masave për garantimin e tyre në mënyrë efektive dhe respektimin e një procesi të rregullt ligjor.

17. Duke pasur parasysh faktin se avokatja e kërkueses kishte dhënë dorëheqjen një ditë përpara seancës gjyqësore, Gjykata çmon se në këto kushte kërkuesja nuk kishte mundësi të siguronte avokat tjetër brenda një kohe kaq të shkurtër. Ky shkak i paraqitur nga kërkuesja ka qenë i arsyeshëm, ndaj Gjykata e Lartë duhej ta shtynte seancën gjyqësore për t'i dhënë mundësi kërkueses të përfaqësohej me avokat, aq më tepër kur edhe seanca paraardhëse ishte shtyrë dhe kërkuesja nuk kishte pasur mundësi të paraqiste mbrojtjen e saj me anë të avokates. Për pasojë, nisur nga rrethanat faktike të çështjes dhe rëndësia që ka e drejta e mbrojtjes në kuadrin e procesit të rregullt ligjor, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Gjykata e Lartë nuk ka marrë të



gjitha masat për të garantuar të drejtën e mbrojtjes. Rrjedhimisht, pretendimi i kërkuësës është i bazuar dhe duhet pranuar.

18. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se në çështjen objekt shqyrtimi është cenuar e drejta e mbrojtjes, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.

- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-3127, datë 4.6.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi

MENDIM PARALEL

1. Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuësës, shoqërisë “Eurondërtim 2000” sh.p.k., për shfuqizimin e vendimit 00-2014-3127, datë 4.6.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë (GJL-ja). Në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës për pranimin e kërkesës, por çmoj të shprehem me mendim paralel, pasi mendoj se një ndër shkaqet për këtë qëndrim duhej të ishte edhe cenimi i parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

2. Shumica ka evidentuar se kërkuësja, shoqëria “Eurondërtim 2000” sh.p.k., i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke

pretenduar se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në Gjykatën e Lartë. Më konkretisht, ajo ka parashtruar se është cenuar e drejta për t’u mbrojtur, barazia e armëve gjatë gjykimit dhe parimi i kontradiktoritetit, pasi Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën e përfaqësimit me avokat (*paragrafi 7 i vendimit*).

3. Referuar nenit 48 të ligjit organik të GJK-së, kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të. Përrjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të kërkesës dhe akteve të tjera normative, vendos për çdo rast Gjykata Kushtetuese. Megjithatë jo vetëm në ligj, por edhe në doktrinën dhe jurisprudencën kushtetuese është njohur prirja e GJK-së për të mos u kufizuar në pretendimet e kërkuësit, ndaj çmoj se Gjykata në shqyrtimin e çështjes duhej të ndalej edhe në argumentimin e cenimit të parimit kushtetues të gjykatës së caktuar me ligj, edhe pse ky parim nuk është argumentuar nga kërkuësja.

4. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Termi “*gjykatë*” karakterizohet në sensin material nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 9.3.2009 dhe nr. 31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Sipas vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë të administruar në gjykim, rezulton se nga pikëpamja formale ky vendim është vendosur nga Kolegji Civil i kësaj gjykate. Ky fakt reflektohet si në pjesën hyrëse të vendimit, ku specifikohet përbërja e Kolegjit Civil të mbledhur për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, ashtu edhe në pjesën e dispozitivit, ku vendimmarrja i përket këtij kolegji bazuar në dispozitat procedurale civile. Ndërkohë, referuar përmbajtjes së vendimit gjyqësor, konkretisht pjesës III, rezulton se arsyetimi i vendimit dhe



zgjdhja e çështjes është vendosur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, sepse në paragrafin 7 të kësaj pjese thuhet se “Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është gjykata kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje gjyqësore [...]”.

6. Referuar standardit të mësipërm për gjykatën e caktuar me ligj, rezulton se kriteri kryesor përcaktues i respektimit të këtij parimi është kompetenca e gjykatës për shqyrtimin e çështjes. Në përputhje me nenin 4, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, rezulton se Gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative, sipas këtij ligji, janë gjykatat administrative të shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

7. Për sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë rrethanat konkrete, ligjin e zbatueshëm në gjykimin e kësaj çështje, si dhe standardet kushtetuese që kanë zbërthyer parimin e gjykatës së caktuar me ligj, çmoj se përcaktimi i Kolegjit Civil (në disa prej pjesëve të vendimit), si trupa vendimmarrëse në këtë çështje, cenon parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

Anëtar: Fatos Lulo

MENDIM PARALEL

1. Gjykata ka pranuar kërkesën e shoqërisë “Eurondërtim 2000” sh.p.k. dhe ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr. 00-2014-3127, datë 4.6.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës, cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë e shoh edhe nën një këndvështrim tjetër.

2. Në vendimin e Gjykatës së Lartë konstatohet, në pjesën hyrëse të vendimit, se gjykata që e ka shqyrtuar çështjen është “Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë” (shih faqen nr. 1 të vendimit të Gjykatës së Lartë). Në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit, ku është dhënë dhe arsyetimi për zgjidhjen e tij, trupi gjykues është “Kolegji Administrativ” (shih faqen nr. 5 të vendimit të Gjykatës së Lartë). Po në këtë pjesë sqarohet se

bazuar në nenin 7/a të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, *gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes është Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (shih paragrafin nr. 7, faqe 5 të vendimit të Gjykatës së Lartë), i cili e ka marrë në shqyrtim atë (shih paragrafin nr. 8, faqe 5 të vendimit të Gjykatës së Lartë).* Gjithashtu, është Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, që ka arritur në përfundimin se objekti i kërkesëpadisë është i pabazuar. Ndërsa në pjesën urdhëruese të vendimit rezulton se vendimin nuk e ka marrë Kolegji Administrativ, por Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile (shih faqen nr. 7 të vendimit të Gjykatës së Lartë).

3. E drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 dhe neni 142/1 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012, nr. 8, datë 16.3.2011, nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

4. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në



gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011, nr. 23, datë 4.11.2008, nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është **logjik, ka kundërthënie, përmban në mënyrë të saktë** referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Nga ana tjetër, Gjykata, në jurisprudencë të vazhduar, ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Termi “*gjykatë*”, në kuptimin material, karakterizohet nga funksioni i posaçëm që ka gjykata për të zgjidhur çështjet që janë në kompetencë të saj, gjatë një procesi të zhvilluar sipas një procedure të përcaktuar me ligj dhe në pajtim me parimin e shtetit të së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 23, datë 23.7.2009; nr. 36, datë 30.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Nga sa më lart, në rastin në shqyrtim, jam i mendimit se vendimi i Gjykatës së Lartë nisur nga arsyet e përmendura më lart (*shih paragrafin nr. 2*), nuk i përmbush kriteret kushtetuese të përcaktuara nga jurisprudenca e kësaj Gjykate lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Ai nuk është logjik, përmban referenca ligjore të pasakta dhe kontradiktore midis tyre. Dispozita e përmendur nga Kolegji i Gjykatës së Lartë në pjesën urdhëruese (neni 480 i KPC-së) lidhet me rastet kur Gjykata e Lartë vendos mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi, kur në fakt çështja është shqyrtuar në seancë gjyqësore dhe është zgjidhur në themel.

8. Gjithashtu, në këndvështrimin tim, mangësitë e lartpërmendura, përveç cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, krijojnë dyshime serioze dhe të bazuara edhe në lidhje me trupin gjykues që konkretisht e ka gjykuar çështjen (Kolegji Administrativ apo Kolegji Civil), çka passjell cenimin edhe të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

9. Si përfundim, mendoj se vendimi i Gjykatës së Lartë, krahas parimeve të evidentuara nga shumica, i ka cenuar kërkueses edhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosrespektimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si edhe të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

Anëtar: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në çështjen me kërkuese shoqërore “Eurondërtim 2000” sh.p.k., si dhe me argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim. Nëpërmjet arsyetimit të saj shumica ka çmuar se “duke pasur parasysh faktin se avokatja e kërkueses kishte dhënë dorëheqjen një ditë përpara seancës gjyqësore, kërkuësja nuk kishte mundësi të siguronte avokat tjetër brenda një kohe kaq të shkurtër. Ky shkak i paraqitur nga kërkuësja ka qenë i arsyeshëm, ndaj Gjykata e Lartë duhej ta shtynte seancën gjyqësore për t’i dhënë mundësi kërkueses të përfaqësohej me avokat, aq më tepër kur edhe seanca paraardhëse ishte shtyrë dhe kërkuësja nuk kishte pasur mundësi të paraqiste mbrojtjen e saj me anë të avokates. Për pasojë, nisur nga rrethanat faktike të çështjes dhe rëndësia që ka e drejta e mbrojtjes në kuadrin e procesit të rregullt ligjor, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Gjykata e Lartë nuk ka marrë të gjitha masat për të garantuar të drejtën e mbrojtjes” (§ 17 i *vendimit*). Nuk pajtohem me këtë përfundim të shumicës për arsyet në vijim.

2. E drejta e mbrojtjes është element thelbësor i një procesi të rregullt. Për garantimin e kësaj të drejte në mënyrë efektive, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre



për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë. Sipas këtyre standardeve edhe Gjykata e Lartë (GJL), njësoj si gjykatat më të ulëta, kur shqyrton çështjen në seancë gjyqësore, ka detyrimin të marrë të gjitha masat për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

3. Krahas detyrimit që u imponon e drejta e mbrojtjes gjykatave, ato duhet të mbajnë parasysh edhe detyrimin sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 § 1 të KEDNJ-së për të përfunduar procesin “brenda një afati të arsyeshëm”, si dhe për miradministrimin e drejtësisë (*Balliu kundër Shqipërisë, 2005*).

4. Në rastin konkret, përpara Gjykatës u shtrua çështja për të vlerësuar nëse GJL-ja mban përgjegjësi për mospërfaqësimin e kërkueses me avokat në gjykimin e zhvilluar në seancë gjyqësore përpara GJL-së.

5. Nga rrethanat e çështjes konkrete rezulton se GJL-ja e ka shtyrë gjykimin e datës 20.5.2014 pas kërkesës së avokates së kërkueses, e cila nuk mund të paraqitej në gjykim për arsye shëndetësore. Në këtë seancë ka qenë prezent administratori i kërkueses Q.S., në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë. Në seancën pasardhëse të datës 4.6.2014, përfaqësuesi i kërkueses Q.S. ka bërë me dije Gjykatën e Lartë, gjatë seancës, se është njoftuar për dorëheqjen e avokates një ditë më parë, ndaj në pamundësi për t’u përfaqësuar gjatë gjykimit me avokat ka kërkuar sërish shtyrjen e seancës. Kjo kërkesë është rrëzuar nga Kolegji i GJL-së me arsyetimin se “nuk krijon bindjen se ka shkaqe të përligjura për shtyrjen e seancës” (§ 8 i vendimit të GJL-së).

6. Nga aktet e administruara konstatohet se Q.S., në cilësinë e përfaqësuesit të kërkueses, ka qenë i pranishëm në një pjesë të seancave të zhvilluara në shkallët e tjera të gjykimit. Ndërsa për sa i përket avokates vërehet se si gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë, ashtu edhe gjatë gjykimit në apel, ajo ka kërkuar disa herë shtyrjen e seancës personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të kërkueses. Shkaqet e shtyrjes kanë qenë pjesëmarrja në gjykime të tjera apo qenia e saj jashtë shtetit (shih kërkesën e datës 15.4.2010, procesverbalin e seancës së datës 18.3.2010 në gjykatën e apelit, si dhe kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2006). Gjykimi i kësaj çështjeje ka filluar në vitin 2005 me vendimin e

gjykatës së shkallës së parë, më pas është shqyrtuar nga GJL-ja, e cila e ka kthyer për rishqyrtim çështjen në gjykatën e apelit dhe, së fundi, është shqyrtuar sërish nga GJL-ja në vitin 2014, vendim i cili kundërshtohet në Gjykatë. Pra, kjo çështje ka marrë rreth 9 vjet për t’u shqyrtuar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

7. Kërkuësja (administratori i saj Q.S.) ka qenë në dijeni të shtyrjeve të seancave gjyqësore nga ana e avokates, si dhe në disa raste ka pranuar të kërkojë shtyrjen e seancave për arsye të mungesës së disponibilitetit të avokates për t’u paraqitur në gjykim. Po kështu edhe në GJL seanca gjyqësore është shtyrë për shkak të mosparaqitjes së avokates së kërkueses në gjykim. GJL-ja e ka shtyrë seancën gjyqësore të datës 20.5.2014 pikërisht për t’i dhënë mundësi kërkueses të siguronte mbrojtjen e nevojshme në gjykim. Megjithatë, kërkuësja ka kërkuar sërish shtyrjen e seancës për shkak të dorëheqjes së avokates së saj një ditë përpara zhvillimit të seancës. Këtë kërkesë GJL-ja nuk e ka vlerësuar të përligjuro. Kërkuësja, edhe pse ka qenë në dijeni të mungesave të vazhdueshme të avokates së saj, nuk ka treguar përgjegjësinë që i takon për marrjen e masave të mjaftueshme për të siguruar mbrojtjen gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, qoftë edhe nëpërmjet zëvendësimit në kohë të përfaqësueses së saj (*shih Tripodi k. Italisë, vendimi 22 shkurt, 1994, GJEDNJ*).

8. GJEDNJ-ja në çështjen *Sannino kundër Italisë, të datës 27 prill 2006*, ka theksuar se “një shtet nuk mund të mbahet përgjegjës për çdo të mangësi që i atribuohet një avokati të caktuar ose të zgjedhur nga i akuzuari. Si pasojë e pavarësisë nga shteti të profesionit të avokatit, administrimi/dhënia e mbrojtjes është në thelb një çështje midis të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, qoftë ky i emëruar në bazë të një skeme të ndihmës juridike ose i financuar privatisht (*shih edhe Cuscani kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 32771/96, § 39, 24 shtator 2002*).

9. Duke pasur parasysh natyrën e marrëdhënies avokat-klient, GJEDNJ-ja ka bërë një dallim të rasteve kur individit e zgjedh vetë avokatin e tij nga rastet kur gjykata i cakton atij avokat kryesisht. Në çështjen *Croissant kundër Gjermanisë, 25 shtator, 1992, GJEDNJ-ja është shprehur: “Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 6. E drejta për t’u mbrojtur nga një avokat i zgjedhur, pavarësisht rëndësisë së marrëdhënies së konfidencialitetit midis avokatit*



dhe klientit, nuk mund të konsiderohet si absolute. Ajo u nënshtrohet domosdoshmërisht disa kufizimeve. Gjykatat padyshim duhet të respektojnë dëshirat e palës për të zgjedhur vetë avokatin, por këto mund të anashkalohen nëse ka arsye të mjaftueshme dhe të rëndësishme, që e bëjnë të domosdoshëm këtë anashkalim në interes të drejtësisë. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se arsyet e gjykatave të brendshme ishin të rëndësishme dhe të mjaftueshme, konkretisht ato u shërbenin interesave të drejtësisë për shmangien e ndërprerjeve dhe të shtyrjeve të gjykimit”.

10. Në çështjen *Balliu kundër Shqipërisë (2005)*, GJEDNJ-ja nuk ka gjetur shkelje të nenit 6, për arsye se “aplikanti ishte përfaqësuar nga një mbrojtës i zgjedhur, i cili nuk e ka kryer detyrën dhe gjykatat e brendshme kanë marrë masa për të garantuar efektivitetin e mbrojtjes duke e shtyrë seancën, për t’i dhënë mundësi avokatit të aplikantit të përmbushte detyrat e tij (gjë të cilën ai nuk e ka bërë)”.

11. Referuar standardeve të mësipërme është e qartë se detyrimi i gjykatave për marrjen e masave të nevojshme që garantojnë të drejtën e mbrojtjes është më i madh në rastet kur avokati caktohet nga gjykata se sa në rastet kur avokati zgjidhet nga vetë pala. Kështu, kur pala e zgjedh vetë avokatin, për shkak të marrëdhënies konfidenciale midis saj dhe avokatit, ajo është përgjegjëse për administrimin dhe efektivitetin e mbrojtjes së bashku me avokatin. Nëse pala ka vërejtje për mënyrën e dhënies së mbrojtjes apo efektivitetin e saj, ajo ka të drejtë ta zëvendësojë avokatin me një tjetër.

12. Për sa më lart, duke pasur parasysh karakteristikat e gjykimit në Gjykatën e Lartë, e cila gjykon mbi çështjet e ligjit bazuar në parashtrimet e palëve dhe dosjen gjyqësore, si dhe interesat e drejtësisë, që kërkojnë një gjykim të shpejtë dhe eficient, vlerësojmë se Gjykata e Lartë i ka dhënë mundësi kërkuarës për të siguruar të drejtën e mbrojtjes.

13. Si përfundim, për sa më lart, ndryshe nga shumica, çmujmë se në rastin konkret pretendimi i kërkuarës për cenimin e së drejtës së mbrojtjes në Gjykatën e Lartë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, është i pabazuar. Për rrjedhojë, kërkesa e paraqitur nga kërkuarësja duhej të ishte rrëzuar.

Anëtarë: Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Sokol Berberi

VENDIM

Nr. 971, datë 17.12.2015

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË KRISTIAN DEMOKRATE TË SHQIPËRISË NË QARKUN SHKODËR, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 17.12.2015, me pjesëmarrjen e:

| | |
|-----------------|-------------|
| Lefterije Luzi | kryetare |
| Denar Biba | zv. kryetar |
| Edlira Jorgaqi | anëtar |
| Gëzim Veleshnja | anëtar |
| Hysen Osmanaj | anëtar |
| Klement Zguri | anëtar |
| Vera Shtjefni | anëtar |

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Kristian Demokratë të Shqipërisë, në qarkun Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Mark Frroku.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 3724/1 prot., datë 3.12.2015, drejtuar KQZ-së, Sekretari Përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Mark Frroku, deputet i zonës zgjedhore qarku Shkodër.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e



vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 37, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore qarku Shkodër, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë, për zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 1 mandat dhe kandidati fitues nga lista shumëmemërore e Partisë Kristian Demokrate e Shqipërisë për qarkun e Shkodër, është si më poshtë: me numër rendor 1 (një) z. Mark Preng Frroku.

Rezultoni se lista shumëmemërore e Partisë Kristian Demokrate e Shqipërisë në qarkun Shkodër i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pikat 2 dhe 3, të Kodit Zgjedhor për dhënien e mandatit kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse.

KQZ-ja, me vendimin nr. 309, datë 9.5.2013, “Për miratimin e listave shumëmemërore të Partisë Kristian Demokrate e Shqipërisë, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumëmemërore të Partisë Kristian Demokrate të Shqipërisë, për 12 zonat zgjedhore.

Referuar nenit 45, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë, kanë vetëm të drejtën për të zgjedhur.

Për të verifikuar plotësimin e kushteve të parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, KQZ-ja, me shkresën nr. 7999, datë 4.12.2015, i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë informacion, nëse kandidatët për deputet në listën shumëmemërore të Partisë Kristian

Demokrate të Shqipërisë, qarku Shkodër, me numër rendor 2 (dy), 3 (tre) dhe 4 (katër) plotësojnë kushtin e përcaktuar në nenin 45, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për t’u zgjedhur deputet në Kuvend.

Me shkresën nr. 7614 prot., datë 14.12.2015, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, i ka dërguar KQZ-së, shkresën nr. 11058/1 prot., datë 14.12.2015 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Referuar shkresave të sipërcituara, kandidati për deputet në listën shumëmemërore të Partisë Kristian Demokrate të Shqipërisë, qarku Shkodër, me numër rendor 2 (dy), z. Arben Preng Froku rezultoi i dënuar si më poshtë:

Dënimi 1

Në bazë të vendimit nr. 10, datë 27.2.1991, Gjykata e Lezhës ka deklaruar fajtor për veprën penale të përvetësimit të pasurisë socialiste në bashkëpunim në shumën 900 lekë, në bazë të nenit 63, 31/ B,31/2 të Kodi Penal dënohet me 6 muaj riedukim nëpërmjet punës me ndalimin e 1/5 e pagës.

Dënim 2

Në bazë të vendimit nr. 52, datë 3.4.2015, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, e ka deklaruar të pafajshëm për veprat penale:

- “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 79/c E25 të Kodit Penal, pasi konform nenit 388, germa “d”, të Kodit të Procedurës Penale, nuk provohet se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

- “Mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, pasi konform nenit 388, germa “d”, të Kodit të Procedurës Penale, nuk provohet se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

- Konform nenit 389 të Kodit të Procedurës Penale, urdhërohet lirimi i menjëhershëm nëse nuk mbahet për ndonjë procedim tjetër penal, duke hequr masën e sigurimit “arrest me burg”, të caktuar me vendimin nr. 60, datë 26.2.2013, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr. 73, datë 29.6.2015, ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit nr. 52, datë 3.4.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, si më poshtë:



Deklarimin fajtor të të pandehurit Arben Preng Frroku për veprat penale:

- Vrasje në rrethana të tjera cilësuese, parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal (ligji i kohës në momentin e kryerjes së veprës penale) dënim me burgim të përjetshëm.

- Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal (ligji i kohës në momentin e kryerjes së veprës penale), dënimin e tij me 5 vjet burgim.

- Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal dënohet përfundimisht me burgim të përjetshëm.

Kandidatët për deputet në listën shumemërore të Partisë Kristian Demokrate të Shqipërisë, qarku Shkodër, me numër rendor 3 (tre) dhe 4 (katër), përkatësisht znj. Mirela Riza Ferracaku dhe Ndok Gjelo Kola, rezultojnë të padënuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit të sipërcituar, kandidati i radhës në listën shumemërore të Partisë Kristian Demokrate të Shqipërisë, qarku Shkodër, me numër rendor 2 (dy) z. Arben Preng Frroku nuk plotëson kushtin e parashikuar nga neni 45, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për t'u zgjedhur deputet në Kuvendin e Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandat i ndërprerë i përket kandidatës së radhës, pas z. Arben Froku, e renditur me numër rendor 3 (tre) në listën shumemërore të Partisë Kristian Demokrate e Shqipërisë në zonën zgjedhore qarku Shkodër, znj. Mirela Riza Ferracaku.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatës së radhës në listën shumemërore të Partisë Kristian Demokrate të Shqipërisë, qarku Shkodër, znj. Mirela Riza Ferracaku.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Faqe | 14610

VENDIM

Nr. 60, datë 14.12.2015

PËR SHQYRTIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 635, DATË 15.7.2015, “PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1252, DATË 10.9.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ZHVILLIMIT TË TENDERIT PUBLIK PËR DHËNIEN E SË DREJTËS SË PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE”, TË NDRYSHUAR

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Z. Arben Ahmetaj kryetar
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtar
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;
- Znj. Anduena Dedja anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës, të datës 14.12.2015, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit””, me kërkesë të Telekom Albania sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a., në cilësinë e palëve të interesuara, mori në shqyrtim vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 15.7.2015, “Për disa shtesa në vendimin nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënie e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar”.

I. Procedura

1. Në zbatim të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit””, Drejtoria e Tregut të Brendshëm në MZHETTS është vënë në dijeni nga operatorët e telefonisë lëvizëse, Telekom Albania sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a., mbi ndryshimet që vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 15.7.2015, ka bërë në lidhje me mënyrën e pagesës së zbatuar në procedurën e dhënies së autorizimit individual.



2. Telekom Albania sh.a. me shkresën nr. prot. 4346/2, datë 6.10.2015, ka paraqitur pranë Komisionit të Ndhmës Shtetërore ankesën lidhur me ndryshimin e vendimit të Këshilli i Ministrave nr. 1252, datë 10.9.2008, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar, ku pretendon se ky ndryshim përbën ndihmë shtetërore të ndaluar.

3. Vodafone Albania sh.a. me shkresën CEO/046/SD, datë 8.10.2015, pretendon se ndryshimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1252/2008, nuk është në përputhje me legjislacionin e ndihmës shtetërore.

4. Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike me shkresën nr. 4741/1, datë 22.10.2015, ka kërkuar nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore vlerësimin, nëse ndryshimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1252/2008, përbën ndihmë shtetërore sipas legjislacionit të ndihmës shtetërore.

II. Përshkrimi i masës

5. Neni 62, i ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, lidhur me administrimin e spektrit të frekuencave, përcakton se:

“1. Spektri i frekuencave është burim natyror i fundmë. Administrimi i spektrit duhet të sigurojë përdorimin e frytshëm dhe efektiv të tij, në përputhje edhe me vendimet përkatëse të organizmave ndërkombëtarë dhe detyrimet, që rrjedhin nga konventat ose nga marrëveshjet, ku Republika e Shqipërisë është palë.”

6. Bazuar në nenin 65, të ligjit nr. 9918/2008, përdorimi i frekuencave nga personat fizikë apo juridikë mund bëhet vetëm pasi të jenë pajisur, paraprakisht, me autorizim nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Pika 2 e nenit 65, parashikon se e drejta e përdorimit të frekuencave kufizohet vetëm në rast se kjo kushtëzohet nga pamjaftueshmëria e frekuencave dhe nga detyrimi për të siguruar përdorimin eficient të tyre.

7. Në rastet e kufizimit, sipas pikës 2, të nenit 65, të ligjit “Për komunikimet elektronike”, AKEP-i përdor procedurën e tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave, pas miratimit paraprak nga ministri (neni 66).

8. AKEP-i, bazuar në nenin 69, zhvillon procedurën e tenderit për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, sipas legjislacionit në fuqi. Procedura duhet të jetë objektive,

transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale për të përmbushur objektivat rregullatorë, të cilët parashikohen në nenin 7 të këtij ligji.

9. Përdorimi i frekuencave pas marrjes së autorizimit individual nga AKEP-i, bëhet kundrejt pagesës, sipas parashikimeve ligjore në nenet 78 dhe 119 të ligjit nr. 9918/2208, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 599, datë 23.7.2010, “Për miratimin e pagesave që kryhen në autoritetin e komunikimeve elektronike dhe postare, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, të numrave dhe të serive numerike”.

10. Me vendimin nr. 1252, datë 10.9.2008, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, Këshilli i Ministrave ka përcaktuar rregullat për organizmin e tenderit publik, procedurat dhe dokumentet e tenderit, zhvillimi i procedurave, si dhe procedurat e rishikimit administrativ.

11. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 15.7.2015, “Për disa shtesa në vendimin nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave””, të ndryshuar, është bërë një shtesë mbi mënyrën e kryerjes së pagesës për dhënien e autorizimit individual. Konkretisht, është parashikuar mundësia që pagesa në një procedurë për dhënien e autorizimit individual mund të bëhet edhe me këste me miratimin e ministrit përgjegjës.

“Kreu III

1.2.1 Aplikimi i pagesës me këste në një procedurë për dhënien e autorizimit individual miratohet nga ministri në momentin e dhënies së miratimit për procedurën sipas shkronjës “b”, të pikës 1.2, të këtij kreu, në rastet kur:

a) Aplikimi i pagesës me këste përshpejton investimet për ofrimin e shërbimeve në interes të publikut dhe sjell rritje të konkurrencës;

b) subjekte të interesuara në procesin e këshillimit kanë kërkuar dhe argumentuar aplikimin e saj në interes të shërbimeve ndaj publikut;

c) procedura për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave në një brez të caktuar frekuencash është zhvilluar më shumë se dy herë dhe ka ende spektër të lirë të papërdorur.”



12. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 635/2015, ka parashikuar dhe modalitetet e pagesës me këste në rast se ajo aplikohet. Pagesa bëhet në buxhetin e shtetit, sipas kalendarit që i bashkëlidhet autorizimit individual dhe kryhet brenda vitit. Për këstet që do të paguhen pas pagesës së parë, aplikohet dhe një *interes mbi këtë pagesë, të llogaritur sipas kursit të bonove të thesarit në momentin e paraqitjes së ofertës*. Moskryerja e pagesës shoqërohet me revokimin e autorizimit individual dhe konfiskimin e sigurimit të ofertës.

“Në rastin e aplikimit të pagesave me këste, autorizimi individual lëshohet nga AKEP-i pas kryerjes së pagesës së parë. Kalendarit i pagesave përfshihet në kushtet e autorizimit individual.”

“1.3 Kur aplikohet pagesa me këste, në dokumentin e tenderit përcaktohet koha për pagesën e parë. Ofertuesi do të paguajë brenda vitit, sipas kalendarit të propozuar në ofertë, pagesat e tjera respektive pas pagesës së parë plus interesin mbi këtë pagesë të llogaritur sipas kursit të bonove të thesarit në momentin e paraqitjes së ofertës. Pagesat do të derdhen prej ofertuesit që ka fituar të drejtën e përdorimit të frekuencës/brezit të tenderuar në buxhetin e shtetit. Moskryerja sipas afatit e pagesave me këste, duke filluar nga pagesa e dytë, çon në revokimin e autorizimit individual nga AKEP-i dhe konfiskimin e sigurimit të ofertës.”

13. Ndryshimet rregullatore kanë hyrë fuqi në gusht 2015 dhe mund të zbatohen me miratimin e ministrit përgjegjës, në procedurat e tenderimit për dhënien në përdorim të spektrit të mbetur të frekuencave.

III. Përshkrimi i ankesave

14. Telecom Albania sh.a., me shkresën nr. prot. 4346/2, datë 6.10.2015, pretendon se ndryshimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1252, datë 10.9.2008, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar, ku në shkronjën “b”, pika “i”, parashikohet se pagesat e operatorit fitues mund të kryhen edhe me këste, në varësi të vendimit të ministrit mbi shpalljen e kritereve të tenderimit, përbën një avantazh të padrejtë konkurrues kundrejt operatorëve të tjerë në treg, e rrjedhimisht ndihmë shtetërore të ndaluar. Telecom Albania sh.a. kërkon që dispozita e sipërcituar të mos aplikohet në procedurat e lidhura me tenderin për spektrin IMT 1900-1980 MHz dhe 2110-2170 MHz për ofrimin e

shërbimit 3G. Me pretendimin se aktualisht Plus Communication është i vetmi operator i telefonisë lëvizëse në treg, që nuk disponon këtë brez frekuencash dhe automatikisht ky operator do të jetë dhe përfituesi direkt i këtij avantazhi të dhënë në formën e pagesës me këste. Zbatimi i procedurës së pagesës me këste për të marrë të drejtën e ofrimit të shërbimit 3G, sipas Telecom Albania sh.a., është procedurë diskriminuese ndaj operatorëve të tjerë që ofrojnë këtë shërbim, por nuk kanë pasur të drejtën e pagesës me këste kur kanë marrë autorizimin individual të përdorimit të frekuencave.

15. Vodafone Albania sh.a., me shkresën CEO/046/SD, datë 8.10.2015, pretendon se ndryshimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1252/2008, në lidhje me mënyrën e pagesave për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave, nuk duhet të zbatohet për procedurën e tenderit për frekuencat 2100 Mhz, pasi cenon cilësinë e shërbimit, ul të ardhurat në buxhetin e shtetit, cenon parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit mes operatorëve të telefonisë dhe nuk është në përputhje me legjislacionin e ndihmës shtetërore.

16. Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, me shkresën nr. 4741/1, datë 22.10.2015 është shprehur lidhur me pretendimet e Telecom Albania sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a., nëse aplikimi me këste në rastin e frekuencave të mbetura në brezin 2.1 Mhz do të përbënte ndihmë shtetërore, duke favorizuar operatorin e katërt të telefonisë celulare. Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike shprehet se ndryshimet e miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1252, datë 10.9.2008, janë parashikuar si një mënyrë alternative pagese. Në rast aplikimi, kjo mundësi do t’u ofrohet të gjitha palëve të interesuara, që marrin pjesë në një procedurë konkurrimi, në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese. Të gjitha kriteret e tjera, të parashikuara me ligj dhe akte nënligjore, për procesin e konkurrimit për dhënien në përdorim të frekuencave, janë të njëjta dhe nuk kanë pësuar asnjë ndryshim.

IV. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

17. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të



ndryshuar, një masë përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen në mënyrë kumulative këto kushte:

- a) aktivizohen burime shtetërore;
- b) jepet një avantazh ekonomik; dhe
- c) ndikim në konkurrencë dhe tregti.

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo lloji forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”

18. Vlerësimi i kriterëve që përcaktojnë nëse një masë përbën ndihmë shtetërore do të bëhet bazuar në ligjin nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, si dhe në praktikën administrative të Komisionit Evropian, jurisprudencën e gjykatave të Bashkimit Evropian, sipas parashikime dhe detyrimit që buron nga nenin 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të Tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë:

“2. Praktikrat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës, të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

19. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se, për arsyet e renditura më poshtë, masa e marrë në shqyrtim nuk plotëson kriteret për t'u konsideruar ndihmë shtetërore.

Avantazhi ekonomik

20. Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 635/2015, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ka parashikuar një rregull të ri, i cili mund të aplikohet në procedurën e zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave. Ky rregull i ri konsiston në mundësin e pagesës me këste në një procedurë për dhënien e autorizimit individual.

21. Zbatimi eventual i kësaj procedure të re është e kushtëzuar me përmbushjen e disa kushteve të përcaktuara në vendimin në fjalë.

22. Kështu, pagesa me këste mund të bëhet:

- a) Me miratimin e ministrit përgjegjës në

momentin e dhënies së miratimit për procedurën e zhvillimit të tenderit.

b) Kur zbatimi i kësaj procedure:

i) përshpejton investimet për ofrimin e shërbimeve në interes të publikut dhe sjell rritje të konkurrencës;

ii) subjekte të interesuara në procesin e këshillimit kanë kërkuar dhe argumentuar aplikimin e saj në interes të shërbimeve ndaj publikut;

iii) procedura për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave në një brez të caktuar frekuencash është zhvilluar më shumë se dy herë dhe ka ende spektër të lirë të papërdorur.

23. Sikundër, është konstatuar dhe në instrumentet interpretuese¹, që përdoren nga institucionet e BE-së, shteti, me anë të institucioneve përgjegjëse shtetërore, nuk është thjesht dhe vetëm një administrator i spektrit të frekuencave por ka edhe rol rregullator.

24. Dhënia e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave nga AKEP-i², në përputhje me objektivat ligjorë³ është pjesë e kompetencave rregullatore të shtetit, dhe në parim përjashtohet nga zbatimi i legjislacionit të ndihmës shtetërore.

25. Pjesë e funksionit rregullator është edhe përcaktimi i procedurave të tenderit për dhënien në përdorim të frekuencave, me qëllim nxitjen e ofrimit të shërbimeve inovative dhe konkurrencën në treg.

26. Me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe ofrimin e shërbimeve inovative, shteti mund të lejojë autoritetet rregullatore të vendosin kushte apo tarifa duke marrë parasysh nevojën për përdorimin sa më optimal të frekuencave, duke zbatuar parimin e mosdiskriminimit dhe të transparencës.

Kuadri rregullator i Shqipërisë

27. Funksioni rregullator i AKEP-it parashikohet në nenin 66, të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar:

“Në përcaktimin e frekuencave që mund të përdoren, sipas autorizimit të përgjithshëm dhe në lëshimin e

¹ ECJ, C-431/07 P, Bouygues and Bouygues Télécom v Commission.; CFI, T-475/04, Bouygues and Bouygues Télécom v Commission; State Aid SA.29191 (2011/NN)

² Neni 8, ligji nr. 9918/2008, i ndryshuar

³ Neni 7, ligji nr. 9918/2008, i ndryshuar



autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave, AKEP-i mban parasysb që frekuencat janë një pasuri kombëtare me vlerë ekonomike dhe rëndësi sociale e kulturore. Dhënia në përdorim e frekuencave nga AKEP-i bëhet në bazë të parimit të objektivitetit, transparencës, proporcionalitetit e mosdiskriminimit, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, radiatorregulloret e ITU-së dhe në përputhje me objektivat rregullatorë të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji.”.

28. Për më tepër, objektivat rregullatorë (neni 7) kërkojnë, që: “AKEP-i të ushtrojë funksionet në përputhje me parimin e ligjshmërisë, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera normative, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike e me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku Republika e Shqipërisë është palë. AKEP-i merr parasysb rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit Evropian dhe BEREC-it.”.

29. Gjithashtu, AKEP-i nxit konkurrencën eficiente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera:

c) për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike;

dh) për të nxitur investimet eficiente në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një cilësi të lartë të produkteve të tyre;

e) për të nxitur përdorimin e frytshëm të frekuencave dhe serive numerike si burime të fundme;

ë) për të siguruar mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Zbatimi i legjislacionit të ndihmës shtetërore

30. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 635/2015, shteti ka ushtruar funksionin e vet rregullator të parashikuar në legjislacionin përkatës. Legjislacioni për komunikimet elektronike nuk ndalon organet shtetërore të vendosin vetë procedurat për dhënie e autorizimeve individuale, apo dhe t'i ndryshojnë këto procedura, për aq sa ky ndryshim është objektivisht i justifikuar dhe bëhet në mënyrë proporcionale⁴. Përcaktimi apo ndryshimi i procedurave bëhet gjithmonë duke reflektuar objektivat rregullatorë, duke mbajtur parasysb

nevojën për nxitjen e konkurrencës, ofrimin e shërbimeve inovative në interesin e publikut apo konsumatorit dhe duke respektuar parimin e objektivitetit, transparencës, proporcionalitetit e mosdiskriminimit.

31. Komisioni vlerëson se, për aq sa aplikimi i pagesës me këste do të bëhet, sipas kushteve dhe në rastet e përcaktuara shprehimisht në vendimin 365/2015, me qëllim për të përshpejtuar investimet për ofrimin e shërbimeve në interes të publikut dhe sjell rritje të konkurrencës; subjekte të interesuara në procesin e kështillimit kanë kërkuar dhe argumentuar aplikimin e saj në interes të shërbimeve ndaj publikut; procedura për dhënie e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave në një brez të caktuar frekuencash është zhvilluar më shumë se dy herë dhe ka ende spektër të lirë të papërdorur⁵, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e ndihmës shtetërore.

32. Komisioni konstaton se skema e propozuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 635/2015 ofron një skemë me fleksibël pagesash të çmimit të autorizimeve individuale, duke synuar të nxisë investimet direkte në zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe në thell kërkesat e parashikuara në procesin e konkurrimit nuk preken, ato mbeten të njëjta.

33. Lidhur me avantazhin selektiv, në dukje, mbi mundësinë e pagesës me këste të fituesit të procedurës së konkurrimit për frekuencat të caktuara, Komisioni vlerëson, se pagesa me këste për një afat njëvjeçar, nuk mjafton për të provuar ekzistencën e ndihmës shtetërore⁶ në kundërshtim me ligjin 9374/2005, duke mbajtur parasysb rregullimet ligjore në fushën e komunikimeve elektronike.

34. Kjo pasi, *së pari*, fituesi i procedurës së konkurrimit është i detyruar të paguajë çmimin e tregut, që do të rezultojë nga procedura e konkurrimit, dhe si fillim të kryejë pagesën e parë *jo më pak se 20% e çmimit të ofertës. Së dyti*, fituesi është i detyruar të kryejë pagesën për pjesën e mbetur (*jo më shumë se 80% të çmimit*) brenda vitit duke minimizuar ndikimin në buxhetin e shtetit, dhe ndërkohë ofertuesi është i detyruar të paguajë edhe një interes të llogaritur sipas kursit të bonove të thesarit në momentin e paraqitjes së ofertës duke zbutur efektet nga

⁵ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 365, datë 15.7.2015, pika 1, shkronja “b/ii”

⁶ CFI, CASE T-475/04, paragraf. 111

⁴ CFI, CASE T-475/04, paragrafi 108



vonesa me kërkesën për arkëtim. Një “avantazh” i përkohshëm në formën e pagesës me këste, *sjell në buxhetin e shtetit një shumë të ardhurash më të madhe se ajo e çmimit të ofertës. Së treti*, kur kjo bëhet për të nxitur konkurrencën efektive në treg, dhe për të maksimizuar përfitimin e përdoruesve në treg, çdo “lehtësi e përkohshme” në dukje nuk sjell përparësi, krahasuar me efektet pozitive që sjell në treg.

35. Për më tepër, aplikimi i pagesës me këste nuk e cenon të drejtën e çdo ofertuesi për paraqitjen e ofertës me një pagesë të vetme me marrjen e autorizimit.⁷

Ndikimi në konkurrencë

36. Komisioni vlerëson se kjo masë nuk e shtrembëron dhe nuk rrezikon të shtrembërojë konkurrencën, përkundrazi, synon të zgjerojë hapësirat e konkurrencës, *përshpejton investimet për ofrimin e shërbimeve në interes të publikut dhe sjell rritje të konkurrencës*, prandaj dhe nuk mund të konsiderohet ndihmë shtetërore.

37. Gjithashtu, Komisioni merr parasysh se investimet në infrastrukturën e komunikimeve elektronike janë investime të mëdha me vlera prej disa milionë eurosh. Në ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të lëvizshme me shpejtësi të lartë, operatorët përballen dhe me pagesën e lartë për vlerën e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave. Pagesa e lartë në momentin e marrjes së autorizimit individual në raste të caktuara mund të frenojë kryerjen e menjëhershme të investimeve nga subjektet, duke sjellë dhe vonesë në përfitimet e konsumatorit për marrjen e shërbimeve të reja.

38. Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, në kuptim të nenit 4 të ligjit për ndihmën shtetërore, në kushtet kur mosplotësimi i të paktën një prej kriterëve të sipërpërmendura nuk provohet, Komisioni i Ndhmës Shtetërore, duke qenë se këto kriterë janë kumulative.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 4 dhe 17, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Masa për pagesën me këste në procedurën e dhënies së autorizimit individual, e parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 15.7.2015, “Për disa shtesa në vendimin nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar nuk përbën ndihmë shtetërore, pasi dy nga kriteret kumulative, avantazhi selektiv dhe shtrembërimi ose rreziku që të shtrembërohet konkurrenca nuk provohen.

2. Të njoftohet pranë Ministrisë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHE/TTS-së) çdo ndryshim i mundshëm i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 15.7.2015, “Për disa shtesa në vendimin nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar”, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 61, datë 14.12.2015

PËR PËRCAKTIMIN E NORMËS SË INTERESIT PËR KTHIMIN E NDIHMËS SHTETËRORE PËR VITET 2010–2015

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Z. Arben Ahmetaj kryetar
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtar
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;
- Znj. Anduena Dedja anëtar.

Në mbështetje të nenit 17, shkronja “d”, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar dhe të nenit 15 të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005,

⁷ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 365, datë 15.7.2015, pika 1, shkronja “b/iii”



VËREN SE:

1. Në nenin 27, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, dhe nenet 15 dhe 16, të rregullores “Për procedurat dhe format e njoftimit”, jepet metoda e përcaktimit të normave të interesit për kthimin e ndihmës shtetërore.

2. Komisioni i Ndhmës Shtetërore ngarkohet të shpallë normën në fuqi të interesit, si dhe rillogaritjet, nëse janë të nevojshme.

3. Norma e interesit llogaritet në bazë të mesatares së normës TRIBOR për muajt shtator, tetor, nëntor të vitit paraardhës, duke i shtuar edhe 0.75 për qind.

4. TRIBOR (Tirana Interbank Offer) përcaktohet sipas rregullores “Mbi llogaritjen e normave fikse të interesit në tregun ndërbankar të parasë”, miratuar me vendim nr. 99, datë 27.12.2006, të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 17, shkronja “d”, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e normës së interesit për kthimin e ndihmës shtetërore të dhënë në mënyrë të paligjshme, për periudhën 2010 deri në 31.12.2015, si më poshtë:

- a) Për vitin 2010 = 10.2%;
- b) Për vitin 2011 = 9.07%;
- c) Për vitin 2012 = 8.88%;
- d) Për vitin 2013 = 8.43%;
- e) Për vitin 2014 = 6.46%;
- f) Për vitin 2015 = 4.59%.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Arben Ahmetaj

VENDIM

Nr. 62, datë 14.12.2015

**PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS
SHTETËRORE “PËR PROGRAMIN E
NXITJES SË PUNËSIMIT TË TË
RINJVE, QË KANË FITUAR STATUSIN
E JETIMIT”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Z. Arben Ahmetaj kryetar
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtar
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;
- Znj. Anduena Dedja anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës, të datës 14.12.2015, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit””, mori në shqyrtim planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit”.

I. Procedura

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me shkresën nr. 6187, datë 2.12.2015, ka njoftuar pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit”.

2. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në cilësinë e dhënësit të ndihmës shtetërore, ka përmbushur detyrimin ligjor për njoftimin e planit të ndihmës para vënies në zbatim, në përputhje me nenet 20 dhe 21, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe nenit 5 e vijues, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit””.

II. Përshkrimi i masës

3. Baza ligjore për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit”, është:

a) Ligji nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, i cili parashikon se:



Neni 4

“1. Politikat shtetërore të punësimit përfshijnë si masat aktive për nxitjen e punësimit, ashtu edhe sigurimin e mbështetjes me të ardhura.

5. Politikat shtetërore të punësimit vendosen nga Këshilli i Ministrave dhe zbatohen nga ministria.”

Neni 8

“Mbajtja e vendeve ekzistuese dhe krijimi i vendeve të reja të punës:

1. Shteti mbështet punëdhënësit që krijojnë dhe mbajnë vende të reja pune dhe punësojnë në to kandidatë të ofruar nga zyrat e punësimit. Mbështetja shtetërore realizohet nëpërmjet:

a) subvencionimit, në përqindje të caktuar, të kostove për sigurimet e detyrueshme dhe të pagës;

b) subvencionimit apo kreditimit për pajisjen e vendit të punës. Punësimi për personat me arsim universitar dhe nga grupe të veçanta nxitet me përparësi.”

b) Ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, i ndryshuar, neni 12 i të cilit parashikon se: “Punësimi i jetimëve bëhet me përparësi nga zyrat e punës e përkuqjesjes sociale”.

c) Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit”, propozuar nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4. Dhënësi i ndihmës është Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kësaj mase është Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

5. Programi ka për qëllim të mbështesë kategorinë e të rinjve nën moshën 30 vjeç, të cilët kanë statusin e jetimit, janë të papunë e të pastrehë dhe janë të regjistruar si punëkërkuar të papunë.

6. Plani i ndihmës parashikon mbështetje të këtij grupi punëkërkuar të papunë, me qëllim lehtësimin e integritimit në jetën shoqërore, ekonomike dhe në tregun e punës, duke u siguruar punësimin e qëndrueshëm të kësaj kategorie.

7. Mbështetja për këtë program do të përballohet nga fondet e buxhetit të shtetit për nxitjen e punësimit, që alokohen çdo vit për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

8. Projektet fituese do të përfitojnë format e mbështetjes nga fondet e nxitjes së punësimit si:

- një financim në masën 10 mijë lekë në muaj për trajnimin nëpërmjet punës, për çdo person, për një periudhë 3-mujore;

- një financim mujor në masën 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore.

9. Punëdhënësit, të cilët përfitojnë nga kjo skemë, janë të detyruar të ofrojnë punësim për punëkërkuarit edhe për 6 muaj të tjerë pas përfundimit të mbështetjes me subvencionim.

10. Zbatimi i skemës do të nisë në vitin 2016 dhe ka një afat të përcaktuar kohor prej 5 vitesh.

11. Skema është e shtrirë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

12. Skema zbatohet për të gjithë sektorët e ekonomisë, për punëdhënësit, të cilët nuk duhet të kenë shkelur në të kaluarën legjislacionin e punës, si edhe duhet të kenë derdhur rregullisht tatimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

13. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, një masë përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen në mënyrë kumulative këto kushte:

a) aktivizohen burime shtetërore;

b) jepet një avantazh ekonomik; dhe

c) ndikimi në konkurrencë dhe tregti.

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdoq formë, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërbortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojnë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”

Aktivizimi i burimeve shtetërore

Masa e njoftuar mbulon koston e pagës në formën e mbulimit të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të pjesës së kontributit të punëdhënësit, si edhe financimin e shpenzimeve të trajnimit të ofruar nga ndërmarrja. Të gjitha këto forma financohen direkt nga buxheti i shtetit, duke aktivizuar fonde shtetërore.

Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti

Masa e njoftuar ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet përfituese dhe i lehtëson nga detyrime financiare, që do të duhet t'i paguanin në kushte normale tregu, duke u dhënë një avantazh ekonomik.

Ndihma ka karakter selektiv, sepse prej saj do të mund të përfitojnë vetëm ato ndërmarrje-/punëdhënësit, që përzgjidhen fitues nga organet e miratimit të projekteve, sipas parashikimeve në



projektvendimin e Këshillit të Ministrave. Ndërmarrjet përfutuese do të aplikojnë me projekte, të cilat do të shqyrtohen dhe do të miratohen nga organet përgjegjëse nga pikëpamja e dobisë social-ekonomike. Rrjedhimisht, jo të gjitha ndërmarrjet që operojnë në treg do të mund të përfitojnë nga kjo masë.

Ndikimi në konkurrencë dhe tregti

Masa e njoftuar ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se forcon pozitën ekonomike të ndërmarrjeve fituese kundrejt ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg.

Sa më lart, masa përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.

IV. Përputhshmëria e ndihmës

14. Komisioni vlerëson se plani i dhënies së ndihmës shtetërore është i përbërë nga dy komponentë a) ndihma shtetërore për trajnim; dhe b) ndihma shtetërore për punësim.

15. Lidhur me ndihmën shtetërore për trajnim, sipas të dhënave nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ndihma do të jepet për trajnim të përgjithshëm dhe intensiteti i saj nuk do të kalojë 30% të kostove të trajnimit, duke qenë më i ulët se intensiteti maksimal i lejuar në nenin 12, shkronja “b”, të ligjit, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.

16. Lidhur me ndihmën shtetërore për punësim, Komisioni konstaton se masa “Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit” jep stimuj për punëdhënësit, me qëllim punësimin e punëkërkuesve të papunë, që u përkasin shtresave vulnerabël, jetim dhe të pastrehë, pjesë e grupeve të veçanta⁸ dhe sipas ligjit për ndihmën shtetërore, konsiderohen si punonjës në vështirësi. Intensiteti i ndihmës që përfitojnë ndërmarrjet është në masën 16.7% të kostove të pagave, duke qenë brenda vlerës së lejuar nga ligji për punonjësit në vështirësi (50% të kostove të pagave).

17. Sa më lart, Komisioni konstaton se masa është e kufizuar në kohë, ka efekte pozitive në nxitjen e punësimit për punonjësit në vështirësi dhe efekti në konkurrencë është i vogël.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 10, 11 dhe 17, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e dhënies së ndihmës shtetërore nëpërmjet programit të nxitjes së punësimit të të rinjve, që kanë fituar statusin e jetimit si një skemë ndihme të lejueshme.

2. Të gjitha planet të cilat ndryshojnë masën e ndihmës duhet të njoftohen dhe marrin miratimin paraprak të KNSH-së.

3. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, brenda datës 31 mars, të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Arben Ahmetaj

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 841 (64-2015-2374), datë 17.11.2015, vendosi shpalljen të vdekur, më datë 1.4.1992, të shtetasit Andre Prifti, i datëlindjes 3.12.1969, i biri i Jorgjit dhe i Kristinës, i lindur në Divjakë.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 864 (64-2015-2438), datë 24.11.2015, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Ismet Kacabumi, i datëlindjes 24.5.1969, i biri i Mustafait dhe i Esmës.

KËRKESË

Shtetasja Engjëllushe Gega (Likaj) e bija e Halitit dhe e Tushes, e datëlindjes 26.9.1957, banuese në Shkodër, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, shpalljen të vdekur të vëllait të saj shtetasit Maksim Likaj, i biri i Halitit dhe i Tushes, i datëlindjes 31.1.1950.

KËRKUESE
Engjëllushe Gega

⁸ Neni 2, pika 20 e ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar.

| | |
|--|-----------------|
| | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë